

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT
TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS
PER AKTIVITETIN:

**"STACION TRANSFERIMI PER MBETJE TE
RREZIKSHME DHE JO TE RREZIKSHME"**

Vendodhja : Spitalle, Durres

Kërkues: Subjekti "ROAN-TRANS" sh.p.k

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator

Elidiana Shehu



Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Altin Ahmeti".

Ing. Elidiana Shehu
(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Elidiana Shehu".

Qershor, 2018

Permbajta e Tabeles

| | |
|--|-----------|
| 1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-SE..... | 2 |
| 1.1 Pershkrim i qellimit te aktivitetit dhe objektive te VNM-se | 2 |
| 1.2 Pershkrim i permbledhur i kuadrit ligjore mjedisore dhe institucional qe lidhet me aktivitetin .. | 2 |
| 2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT | 4 |
| 2.1 Pershkrimi i Qellimit te Aktivitetit | 4 |
| Instalimi per Ndarjen e vajrave industrial (Tehnix) | 5 |
| 2.1.1 Njesia e qeverisjes vendore qe administron zonen ku do zhvillohet aktiviteti | 7 |
| 2.1.2 Popullsia dhe aktivitet kryesore ekonomike te zones | 7 |
| 3. PERSHKRIM I NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE AKTIVITETIT | 9 |
| 3.1 Ndikimet negative ne mjedis..... | 9 |
| 3.1.1 Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se aktivitetit..... | 10 |

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-SE

1.1 Pershkrim i qellimit te aktivitetit dhe objektivave te VNM-se

Shoqëria Roan Trans sh.p.k. synon të zhvillojë aktivitet për stacion transferimi të mbetjeve të rrezikshme dhe të mbetjeve jo të rrezikshme. Aktiviteti i propozuar ka si synim kryesor përgatitjen e sipërfaqes dhe përshtatjen e saj me llojin e aktivitetit që do zhvillohet në të. Objekti i cili do përdoret për stacionimin e mbetjeve, si të rrezikshme edhe ato jo të rrezikshme, është i ndertuar. Referuar dokumentit të pronësive ai ka një sipërfaqe prej 145 m².

Ky aktivitet është planifikuar të zhvillohet në Zonën Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik Spitallë shpallur si e tillë me VKM nr. 262 datë 06.04.2016. Kjo ZTZE shtrihet pranë qytetit të dytë për nga zhvillimi ekonomik në Shqipëri, Durrësit, vetëm 30 km larg Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza" dhe 37 km nga kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana. Spitalla është 6.4 km larg nga porti i Durrësit, i cili është më i madhi në vend dhe ka 4 terminale të dedikuara për transportin e mallrave. Ky pozicion si dhe ekzistenca e rrjetit rrugor e bën zonën shumë të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike.

Synimi kryesor i kryerjes së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të një aktiviteti të propozuar, është konsiderimi i çështjeve që lidhen me mjedisin që në fazat më të hershme të tij. Në thelb të vlerësimit mjedisor të aktivitetit qëndron evidentimi i ndikimeve të tij me legjislacionin në fuqi, vlerat natyrore që gjenden në zonën e prane dhe si e sa do të ndikohen në rast të funksionimit të tij. Nëpërmjet identifikimit të ndikimeve të mundshme negative të funksionimit të tij në vlerat natyrore të zonës pritëse, që në fazën e idese mund të merren masat e nevojshme për përmirësimet e duhura teknologjike, me qëllim zbutjen e ndikimeve dhe përshtatjen e saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

Për arritjen e këtij qëllimi, VNM duhet të përmbushë këto objektiva:

- Evidentimin e pikëprerjeve dhe bashkërendimit të projektit me kuadrin rregullator legjislativ kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
- Identifikimin e statusit mbrojtës të zonave ku do të zhvillohet projekti;
- Përshkrimin e vlerave natyrore dhe mjedisore në zonën e projektit;
- Identifikimin e ndikimeve të mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime.

Raporti i VNM përmban një përshkrim të projektit të propozuar, përshkrimin e karakteristikave të mjedisit ekzistues pritës, analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis të projektit të propozuar, planin e masave për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve të mundshme negative dhe programin e monitorimit mjedisor.

1.2 Pershkrim i permbledhur i kuadrit ligjore mjedisore dhe institucional që lidhet me aktivitetin

Në kuadër të reformave të rëndësishme administrative dhe ligjore që vendi ynë ka ndërmarrë për të krijuar marrëdhënie më të afërta me vendet anëtare të BE, është zhvilluar në një shkallë të konsiderueshme edhe paketa ligjore e lidhur me menaxhimin e integruar të mbetjeve. Kjo bazë ligjore është ngritur kryesisht mbi Direktivën Evropiane Kuadër të Mbetjeve (2008/98/EC) dhe vijon të plotësohet më tej duke përfshirë edhe aktet nënligjore përkatëse.

Gjatë hartimit të këtij raporti janë konsultuar aktet ligjorë bazë të mëposhtëm:

- Ligji kuadër nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"

- Ligj nr.10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Ligj nr.162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”
- Ligjin Nr.6/2018 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”
- Ligj nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis

Njëkohësisht, janë konsultuar aktet e mëposhtëm të cilët përcaktojnë standartet aktualë për mbrojtjen e biodiversitetit, shkarkimet në ajër, në ujëra dhe menaxhimin e mbetjeve:

- VKM nr. 99 datë 18. 02. 2005 “Për aprovimin e Katalogut Shqiptar për klasifikimin e mbetjeve”.
- VKM nr.798 datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”
- VKM nr.371 datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”.
- **VKM nr 765 date Nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”.**
- VKM nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- Vendim nr.435 datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM nr.803 datë 04.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”.
- VKM nr.435 datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.
- VKMnr.313, datë 09.05.2012 “Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis”.
- VKM nr.267 datë 07.05.2014 “Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore”.
- VKM nr.123, datë 17.2.2011 “Për menaxhimin e zhurmave”.
- VKM nr.371 datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”.
- VKM nr.686 datë 29.07.2015“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”.


2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 Pershkrimi i Qellimit te Aktivitetit

Qëllimi i aktivitetit është **Stacion Transferimi i Mbetjeve te Rrezikshme** te cilat i referohen vajrave portuale, te portit te Duresit me te cilin subjekti “Roan Trans” ka lidhur kontrate Prokurimi “Sherbime” Pastrimi i ambienteve te jashtme te APD-se. Si dhe **Stacion Transferimi i Mbetjeve Jo te Rrezikshme**, mbetje te cilat i referohen Fraksionet e ndara (përveç 15 01 , ambalazheve), Mbetjet e kopshteve dhe parqeve (përfshirë mbetjet e varrezave), Ambalazhe (duke përfshirë mbetjet e paketuara urbane), Mbetje Urbane, Mbetje te paspecifikuara, Mbetje qe dalin nga perpunimi i drurit, mbetje nga impjantet e trajtimi etj.



Figure 1 Harta e zones ne vleresim



Vendodhja e aktivitetit

Aktiviteti Stacion Transferimi per Mbetje te Rrezikshme dhe Mbetje Jo te rrezikshme, do te zhvillohet ne zonen teknologjike Spitalle Durres ne pronen me nr pasurie Nr. 283/3/ND dhe zone kadastrale 8517.



Harta treguese e regjistrimit

Subjekti do te pajiset me te gjithë infrastrukturen e nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te tij Stacion Transferimi per Mbetje te Rrezikshme dhe Mbetje Jo te Rrezikshme. Do te marri masat per shtrimin e siperfaqes ku do te realizohet procesi i grumbullimit dhe ruajtjes se mbetjeve , qe te mos ndikohen nga agjentet atmosferik, deri ne mometin qe do i dorezohen subjekteve te cilat jane te licensuara per trajtimin e tyre.

Soqeria Roan Trans, mbledh vajrat e nga pastrimi i ambjenteve portuale, e grumbullon ato ne siperfaqen e aktivitetit, ben ndarjen e tyre dhe me pas ia dorezon subjekteve te licensuara per trajtimin e vajrave te perdorur.

Instalimi per Ndarjen e vajrave industrial (Tehnix)

Instalimi i separatorit te vajrave industriale ka per qellim dhe eshte projektuar per diferencimin e substancave vajoreore nga uji ne mbetjet vajore me origjine industriale. Nga ky trajtim do te perfthohet ujil pastruar ne cilesi shume te larte, me deri ne 5 mg / l te permbajtjes se perberjeve vajore dhe grimcave te tjera ne suspension.

Proçesi konsiston ne eliminimin e materialeve me densitet me te vogel se uji (sikurse jane vajrat) dhe lendeve te tjera ne suspension (llumi, rera, zhavorri, hiri nga reshjet, perfshi ujerat e paperpunuara me vaj). Efektiviteti i kesaj pajisje varet nga temperature e ujit, dendesia dhe permasa e pikave vajore , si dhe sasia dhe karakteristikat e materialeve te tjera ne suspension.

Testet paraprake te teknologjise TEHNIX per 'instalimin e ndaresit te vajrave te perdorur' kane treguar efektivitet maksimal ne rastin trajtimit te perberjeve me pika yndyrore me diameter deri ne 0.015 cm (15 mikron). Ne kete rast eshte bere e mundur pastrimi i ujit nga vaji ne masen 95-99 %.

Instalimi i ndaresit te yndyrnave TEHNIX do te behet nentoke dhe te gjitha pjeset e tij kanë dimensione te mirecaktuara, të harmonizuara me vëllimin dhe sasine e prurjes (60 – 250 l / sec).

Pajisja perbehet nga fletë metalike prej çeliku dhe profile te ndara te imta, te vendosura brenda në një strukture solide funksionale dhe të qëndrueshme. Shtresat e ndarësit gjithashtu janë bërë prej fletë metalike prej çeliku dhe jane me trashësi = 3, 4, 5, 6 dhe 8 mm.



2.1.1 Njesia e qeverisjes vendore qe administrojnë zonen ku do zhvillohet aktiviteti

Zona Gjeografike: Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë. Kurbin,

Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz.

Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.

Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug. Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit e thekson tiparin e kësaj bashkie si zonë turistike, pasi përveç plazhit të Durrësit asaj i shtohet i gjithë gjiri i Lalëzit si dhe Kepi i Rodonit, të cilat deri tani kanë qenë pjesë e komunave Ishëm, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.



Durrësi ka gjithashtu portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë njën më të rëndësishme tregtare në vend.

Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manufakturën, ndërsa joshja nga turizmi ka shkaktuar gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit. Durrësi është një zonë me shkallë të lartë të migrimit të brendshëm, gjë që ka sjellë zgjerimin e shpejtë dhe informal të qytetit në zonën e ish-Kënetës si dhe përgjatë vijës bregdetare në jug të qytetit.

Durrësi është gjithashtu një zonë e rëndësishme arkeologjike, pasi nën qytetin aktual gjenden disa shtresa qytetërimesh antike. Zbulimet arkeologjike janë të shumta, ndërsa ndërtimet e dekadave të fundit kanë dëmtuar një pjesë të kësaj trashëgimie.

2.1.2 Popullsia dhe aktivitet kryesor ekonomik te zones

Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Durrës banojnë 175,110 vetë ndërsa sipas regjistrimit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 517 banorë km² ndërsa sipas Regjistrimit Civil është 680 banorë km².

Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz.

Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.

Bashkia Durrës

| Qarku | Qendra e Bashkisë | Njësitë administrative përbërëse | Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre | Popullsia sipas Census 2011 | Popullsia sipas Regjistrimit Civil | Sipërfaqja KM ² |
|--------|-------------------|----------------------------------|---|-----------------------------|------------------------------------|----------------------------|
| Durrës | Qyteti Durrës | Durrës | Qyteti Durrës | 175,110 | 299,989 | 338.3 |
| | | Sukth | Qyteti Sukth, Fshatrat; Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori | | | |
| | | Ishëm | Fshatrat; Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjuricaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj, | | | |
| | | Katundi i ri | Fshatrat; Katundi i ri, Jubë, Qerret, Flakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik | | | |
| | | Rrashbull | Fshatrat; Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanxhije, Xhafzotaj, | | | |
| | | Manëz | Qyteti Manëz, Fshatrat; Armath, Borç, Hamallaj, Kameron, Radë, Shkallë, Fshat Manëz | | | |

Durrësi ka portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë njëjën më të rëndësishme tregtare në vend.

Me mbi 5600 aktivitetet ekonomike të tij dhe 15% të investimeve të huaja, Durrësi është renditur në vendin e dytë si ekonomia më e fortë e vendit, pas Tiranës.

Në sektorin e prodhimit, 45% e ndërmarrjeve zhvillojnë aktivitet në industrinë ushqimore, ndërsa pjesa tjetër prej 55% në industrinë e lehtë. Në industrinë ushqimore aktivitet kryesorë janë furrat e bukës, përpunimi i mishit (prodhim sallamesh e proshutash), prodhimi i birrës, kantinat e verës, fabrikat e miellit dhe prodhimit të brumrave etj.

Industria e lehtë përfshin aktivitete të tilla si prodhim veshmbathje dhe këpucë, prodhime alumini, prodhim kimikatesh, industri e përpunimit dhe riciklimit të letres, prodhim i lëndëve larëse.

Kompanitë e tjera zhvillojnë aktivitete në fushën e turizmit, ndërtimit, tregtisë dhe komunikacionit. Sipas të ardhurave që realizojnë, 829 prej tyre konsiderohen si aktivitete të biznesit të madh.

Ndër kompanitë më të mëdha që zhvillojnë aktivitet në rrethin e Durrësit renditen AIBA kompani (prodhim i vezëve dhe një ndër më të mëdhatë në vend me aktivitet edhe në tregjet lokalë), kantina e pijeve alkolike Gjergj Kastrioti Skënderbeu, SUCRALBA (përpunim dhe paketim artikujsh ushqimorë si sheqer, oriz, makarona etj.), ALBMAR (përpunim peshku, eksportuese produktesh), TEUTA EB, ALBI F etj.

Porti i Durrësit mbulon rreth 85% të import-eksporteve shqiptare të mallrave dhe pjesën më të madhe të transportit detar të udhëtarëve. Në portin e Durrësit ngarkohen dhe shkarkohen të gjitha llojet e mallrave minerale, karburante, çimento dhe artikuj të kategorive të ndryshme. Në port gjendet dhe terminali i trageteve.

Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manifakturën, ndërsa joshja nga turizmi ka shkaktuar gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit. Turizmi veror dhe kulturor është një industri me ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Durrësit. Me mbi 750.000 vizitorë në vit, kjo është zona më e rëndësishme e vendit në lidhje me turizmin masiv. Sipas Zyrës Rajonale të Punës të Durrësit, forcat aktive për të punuar llogariten rreth 54,000 njerëz. Niveli i të papunëve për rrethin e Durrësit shkon në rreth 10,38%, ku papunësia është më e përhapur te femrat. Sektori privat ka punësuar rreth 31,3%, i ndjekur nga sektori bujqësor privat me 36,7%, dhe sektori shtetëror me 21,3%.

3. PERSHKRIM I NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE AKTIVITETIT

3.1 Ndikimet negative ne mjedis

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për t' u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve; forma e shfaqjes së tyre, dhe në mënyrë më analitike ndikimet e çdo operacioni të kryer, sidomos mbi burimet natyrore të parinovueshme.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Për një vlerësim sa më profesional të ndikimeve dhe pasojave të aktivitetit në mjedisin fizik dhe social është përzgjedhur të aplikohet metodika dhe procedurat e mëposhtme:

- njohja me aktivitetin dhe teknologjinë e tij, mënyrën e operimit ;
- njohja me infrastrukturën ekzistuese dhe nevojën për infrastrukturë të re për aktivitetin;
- njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis;
- njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes;
- konsultimi me shumë dokumenta e raporte të VNM për veprimtari të njëjta.

Për të ndjekur një rrjedhë logjike të vlerësimit të ndikimeve në mjedis, të paraqitur me anë të tabelave të mëposhtme, procesi është konceptuar në faza që përkojnë me fazat e aktivitetit dhe konkretisht,

- në fazën e funksionimit të aktivitetit;
- në fazën e mbylljes, rehabilitimit të aktivitetit dhe riaftësimi të proceseve natyrore.

Raporti i Vlerësimit të ndikimit në Mjedis identifikon llojet e mëposhtme:

- Ndikimet negative;
- Ndikime pozitive;
- Ndikimet e drejtpërdrejta që vijnë nga operacionet që janë pjesë përbërëse e aktivitetit;
- Ndikimet jo të drejtpërdrejta të cilat janë të dukshme dhe shkaktojnë efekte në një tjetër drejtim;
- Ndikimet kumulative, të dukshme, të krijuara nga akumulimi i efekteve të dukshme në një zonë të veçantë, rishfaqja e efekteve të disa llojeve në zona të ndryshme, ose bashkëveprim të efekteve të ndryshme për shumë kohë ose nga kombinimi i efekteve të ardhura si pasojë e bashkëveprimit me projekte të tjerë të mundshëm.

Është e rëndësishme të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve:

- Ndikime të kthyeshme në mjedis;
- Ndikime të pakthyeshme në mjedis.

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim e proceseve natyrore dhe rigjenerim të ekosistemit.

3.1.1 Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se aktivitetit

Ndikimet në mjedis nga zhvillimi i aktivitetit Stacion transferimi i Mbtjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme:

- Ndikimet e mundshme/aksidentale gjatë operacioneve të transportit kanë si burim kryesor pakujdesinë dhe moszbatimin e protokollit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve (Transporti I ketyre mbetjeve do te kryhet nga subjekt I licensuar) .
- Ndikimet e vetme të trajtimit me sistemin e zgjedhur përfshijë emetimet e mundshme në ajër të aromave dhe shkarkimet aksidentale si rezultat i transportit dhe paramagazinit të tyre në pritje të trajtimit.
- Sa lidhet me shkarkimet e lëngëta, në paragrafin mbi përshkrimin e sistemit të ndarjes se vajrave te perdorur industrial , gjate procesit ndares, per shkak te dendesise se tij zhvendoset midis shtreses substancave te dekanutara ne fund te rezervuarit, dhe shtreses se vajrave ne pjesen e siperme. Ne fund ai filtrohet ne dhomen 3 te rezervuarit dhe perthithet nga porta ´dalese` permes nje pompe uji.
- Ndikimet e mundshme/aksidentale gjatë operacioneve të transportit te mbetjeve kanë si burim kryesor pakujdesinë dhe moszbatimin e protokollit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo te rrezikshme. (Transporti I ketyre mbetjeve do te kryhet nga subjekt I licensuar) .